

BASHKIA GRAMSH
NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA

Bashkia Gramsh njofton të interesuarit /konkurentët se kërkon të japë me qira sipërfaqe të fondit pyjor/kullosor .

1. Fillimin e procedurave të konkurimit publik për dhënien me qira të fondit pyjor, ngastrat/nëngastrat pyjore nr.1/e, 2/b,dhe 23/d të ekonomisë pyjore “Galigat-Storë”,Zona Kadastrale 1556, 3262 dhe 1736.
2. Qëllimi i dhënies me qira të kësaj sipërfaqe është “Për vendosje stacionesh , bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë” si dhe sigurimi i të ardhurave për bashkinë Gramsh .

4. Cmimi dysHEME për fillimin e konkurimit do të jetë 1 716 000 (një milionë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë/vit mbështetur në Raportin Teknik nr.4010 datë 16.09.2024 dhe tarifata e përcaktuara në VKM nr.267, datë 27.04.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr.559, datë 29.07.2022” “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar ,për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” .
5. Afati i dhënies me qira do të jetë 10 vjet.
6. Veprimtaria që do të ushtrohet në sipërfaqen që do të jepet me qira, bazuar në Raportin Teknik nr.4010 datë 16.09.2024 do të jetë ” Për vendosje stacionesh , bazamente për panele fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë ”
7. Personat fizikë dhe juridikë që do të marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:
 - a) kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
 - b) ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
 - c) projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
 - d) planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
 - e) të dhëna për kapacitetet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
 - f) planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
 - g) nivelin e punësimit në veprimtari;
 - h) lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar;
 - i) çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
 - j) adresën e subjektit, telefon, email dhe faks.
7. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurrim, janë:
 - a) garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes(për këtë të paraqesë sigurimin e ofertes ne masen 2% të vlerës së investimit të parashikuar);
 - b) të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
 - c) vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.
8. Vlerësimi i ofertës mbështetet në grumbullimin e pikëve si më poshtë:
 - a) projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit 20 pikë;
 - b) planbiznesi dhe investimet që do të bëhen 15 pikë;
 - c) planin e rehabilitimit të sipërfaqes 25 pikë;
 - d) nivelin e punësimit në veprimtari 5 pikë;
 - e) masën e qirasë për ha/vit 35 pikë.

Dokumentacioni i konkurimit të paraqitet në një zarf ,të mbyllur ,të nënshkruar nga konkuresi me mbishkrimin ”Ofertë për dhënien me qira” sipas objektit të konkurimit dhe i dorëzohet komisionit në orën dhe datën e hapjes së konkurimit.

Mospraqitja e njërit prej dokumentave të mësipërme përbën shkak për skualifikim.

Vendi i zhvillimit të konkurimit : Sheshi Kamber Dërmyshi”,Godina e Bashkisë Gramsh, Kati i dytë, zyra nr.2.

Dokumentat e konkurimit mund të tërhiqen pranë Autoritetit Kontraktor , ,kundrejt kërkesës me shkrim (të firmosur e vulosur) dhe kundrejt pagesës përkatëse(500 leke).

Ofertat dorëzohen nga të interesuarit /konkurentët, fizikisht,me postë ose dorazi ne vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave të interesuarve /konkurentëve është data 01.11.2024 ora 10.00.

Afati për hapjen e ofertave të konkurentëve do të jetë data 01.11.2024 ora 10.00, Godina e Bashkisë Gramsh, Kati i dytë, zyra nr.2.